



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:076774

Datë: 07.12.2020

Numri i dokumentit: 01323874

P.nr.413/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit B. B nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.954/2020, të datës 56.06.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, mori dhe publikisht me datën 02.12.2020 shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. B, nga babai N. dhe nëna L., e lindur I, i lindur me datë ... në Francë ndërsa me vendbanim në Gjilan, rruga ,kompleksi, i pa martuar, student i fakultetit të Arkitekturës në Universitetin i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 16.03.2020 rreth orës 19:25 minuta, në Gjilan, te pandehurit B. B i është gjetur në posedim substanca narkotike e llojit Marihuanë, në atë mënyrë që zyrtarët policor pasi kanë vërejtur një veturë e tipit me targa të regjistrimit ... e ndaluar në afërsi , në Gjilan dhe pas kontrollimit të veturës, në ulësen e parë për pasagjer, ku ishte i ulur tani i pandehuri B. B, në dysheme të veturës është gjetur një sasi e substancës narkotike, e njëjta është sekuestruar ndërsa i pandehuri shoqërohet në stacionin e policisë dhe pas verifikimit dhe testit fushor, rezulton se substanca e sekuestruar është e llojit dhe peshon 0.9 gram, ndërsa i pandehuri e pranon se substanca narkotike është e tij, në këtë mënyrë është vërtetuar se i pandehuri me veprimet e veta, pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë të rrezikshme narkotike,

-Me çka ka kryer veprën penale, posedim i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës,

andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin B. B:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej nga 300 € (treqind euro), të cilën i pandehuri i lartcekur obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet nga një ditë burgim.

Po ashtu në bazë 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga i pandehuri B. B KONFISKOHET substanca narkotike e llojit në peshë 0.9 gram, e cila pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet te përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe në bazë të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 26.06.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.954/2020, kundër të pandehurit B. B nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Më datë 02.12.2020, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Leonora Kadriu dhe i pandehuri B. B, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri i lartcekur si dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër ..., i datës 16.03.2020, raporti i testit fushor, deklaratat e të pandehurit B. B e dhënë në Stacionin Policor në Gjilan me datë 16.03.2020, fotokopja e letërnjoftimit në emër të pandehurit, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve si dhe shkresat e bashkangjitura në lëndë dhe se gjykata po ashtu ka konstatuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri B. B ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshtuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind euro), ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësinë penale të kryesit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale përkatësisht i njëjti fajësinë për kryerjen e kësaj vepre e ka bërë në çdo fazë të procedurës, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, i njëjti ka kërkuar falje për veprimet e tij, po ashtu gjykata mori parasysh faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale si dhe moshën e tij meqenëse i njëjti është i moshës relativisht të re përkatësisht i njëjti është i moshës 21 vjeçar, gjykata po ashtu ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet i pandehuri është student dhe për të është hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për asnjë lloj të veprave penale, ndërsa në rastin konkret gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese të paraparë si në nenin 70 paragrafi 2 të KPRK-ës. Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit mori parasysh edhe gjendjen ekonomike të të pandehurit e cila sipas tij por edhe shkresave të lëndës del të jetë e mesme dhe rrjedhimisht gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar si më lartë të njëjtit por as anëtarëve të tjerë të familjes së tij nuk i

rrezikohet mirëqenia e tij ekonomike andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të prokurorit të shtetit si dhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga i pandehuri B. B ka konfiskuar substancën narkotike e llojit në sasi prej 0.9 gram.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë të paguajë paushallin gjyqësor 30 € (tridhjetë euro) si dhe në bazë të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 € (tridhjetë euro) , në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.4138/20, me datë 02.12.2020

Zyrtare ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.